



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË OBILIQIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit (KO), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Obiliqit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit.
- A2 Parregullsitë në procesin e subvencionimit.
- A3 Vonesa në pagesën e obligimeve ndaj kontraktuesve.
- B1 Parregullsi në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Obiliqit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Obiliqit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Obiliqit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Obiliqit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Obiliqit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: Parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit, parregullsi në zhvillimin e procedurave të prokurimit, parregullsitë në procesin e subvencionimit, vonesa në pagesën e obligimeve ndaj kontraktuesve, mangësitë në menaxhimin e pasurisë jokapitale. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së PVF-të të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me dymbëdhjetë (12) rekomandime, prej tyre nëntë (9) janë rekomandime të reja, dhe tre (3) rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mos zhvillimi i procedurave të rekrutimit përmes SIMBNJ-së dhe mos publikimi i informatave rreth procedurave të rekrutimit

Gjetja Ligji nr. 06/L-114 për zyrtarët publik, neni 68, përcakton që hapja e procedurës së konkurrimit shpallet nga njëra e burimeve njerëzore, në ueb faqen e konkurremeve të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ).

Njoftimet dhe procedurat e rekrutimit për shërbyesit publik, për personelin arsimor dhe mjekësor, nuk janë zhvilluar përmes SIMBNJ-së. Në rekrutimet për mësimdhënës, përveç konkursit publik, asnjë informatë tjetër rreth procesit të rekrutimit, si lista e ngushtë, njoftimet dhe rezultatet e testit me shkrim, intervistat dhe renditja përfundimtare e kandidatëve, nuk janë publikuar në ueb faqen e komunës.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit të dobët të kontrolleve të brendshme dhe mos zbatimit të kërkesave ligjore për procedurat e rekrutimit të personelit.

Ndikimi Mos publikimi i njoftimeve rreth procedurave të rekrutimit krijon jo transparencë rreth procesit dhe u pamundëson aplikantëve informimin rreth procesit të rekrutimit.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se procesi i rekrutimit të personelit zhvillohet sipas të ligjit për zyrtarët publik. Njoftimet dhe procedurat e rekrutimit duhet të zhvillohen përmes ueb faqes së konkurremeve të SIMBNJ-së dhe ueb faqes së komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Parregullsi në procesin e subvencionimit

Gjetja Rregullorja MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 8.3 përcakton që komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve përbëhet nga pesë (5) anëtarë.

Në dy (2) procedura të ndarjes së subvencioneve në vlerë 21,502€, komisioni vlerësues ishte i përbërë prej tre anëtarëve.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve joadekuate dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme.

Ndikimi Mos aplikimi i kërkesave të rregullores, krijojnë parakushte që procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve të mos zhvillohet si duhet.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë që përbërja e komisionit vlerësues të jetë në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren MF-Nr.04/2017.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Vonesa në pagesën e obligimeve ndaj kontraktuesve

- Gjetja** Sipas LMFPP çdo faturë apo kërkesë për pagesë duhet të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim.
- Pesë (5) fatura për mallra dhe shërbime në vlerë totale 10,318€, dhe dy (2) fatura për investime kapitale në vlerë 68,190€ nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditëve. Vonesat ishin nga 8 ditë deri në 6 muaj.
- Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos efektivitetit të kontrolleve gjatë procesimit të lëndëve për pagesë nga zyrtarët financiarë.
- Ndikimi** Pagesa me vonesë e obligimeve ndaj furnitorëve mund ta ekspozojë Komunën para padive për mos pagesë me kohë të obligimeve dhe kjo do të shkaktojë kosto shtesë buxhetore për shkak të kamatave dhe shpenzimeve të përmbarimit.
- Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë se obligimet financiare ndaj kontraktuesve paguhen brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditëve nga pranimi i faturës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B1 - Parregullsi në procedurat e prokurimit publik**

- Gjetja** Ligji për Menaxhimin e Financave Publike (LMFPP), neni 36, kërkon që para inicimit të një procesi të prokurimit, të regjistrohet zotimi në SIMFK. Me njoftimin për kontratë është kërkuar që vlera e sigurisë së ekzekutimit të jetë 10% e vlerës së kontratës.
- Kontrata publike për *Furnizim me dru dhe pelet për institucionet shkollore* në vlerë 40,000€ ishte nënshkruar pa zotim paraprak të mjeteve financiare në SIMFK. Zotimi dhe Urdhërblerja ishin bërë 45 ditë pas nënshkrimit të kontratës, përkatësisht pas skadimit të kontratës e cila kishte afat realizimi 10 ditë.
- Te kontrata publike për *Mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare*, në vlerë të peshuar 13,458€, siguria e ekzekutimit të kontratës nga fituesi i tenderit nuk ishte bërë 10% e vlerës së kontratës 61,635€, përkatësisht 6,163€ por në vlerë 4,000€ bazuar në vlerën e parashikuar. Për këtë kontratë, Komuna kishte parashikuar 40,365€, përderisa oferta e fituesit është 61,635€, duke tejkaluar vlerën e parashikuar.
- Gjithashtu, te kontrata për *Digjitalizimin e rrugëve dhe objekteve publike* në vlerë 23,218€, urdhërblerja ishte bërë 26 ditë pas skadimit të kontratës.
- Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në proceset e prokurimit publik.
- Ndikimi** Kontratat mund të mos realizohen në mungesë të mjeteve të nevojshme buxhetore. Vlera e sigurisë së ekzekutimit mund të mos i mbulojë dëmet e mundshme nga mos realizimi i kontratës.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që nënshkrimit të kontratës ti paraprijë zotimi i

mjeteve financiare në SIMFK, dhe të pasohet më tej me përgatitjen e urdhërbljes për furnizimet apo shërbimet e kontraktuara. Ofertat nuk duhet të tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës, dhe se vlera e sigurisë së ekzekutimit të kontratës bëhet siç përcaktohet me njoftimin për kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen e Pasqyra Vjetore Financiare (PVF).

Çështja A4 - Korrigjimi i Pasqyrave Vjetore Financiare

Gjetja

Përgatitja e PVF-ve duhet të bazohet në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme si dhe sipas Rregullores MF-Nr. 01/2017 për Raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Komuna ka përgatitur dhe dërguar në Thesar PVF sipas afatit të paraparë deri më 30 Janar. Me rastin e rishikimit të PVF, nga ana e auditimit janë vërejtur disa çështje të cilat ju kanë rekomanduar komunës për korrigjim. Çështjet të cilat janë identifikuar ishin:

- Te pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pagesat nga financimet e huamarrjes në vlerë 20,389€, janë prezantuar te fondi zhvillimor në mirëbesim.
- Te shpalosja e ndarjeve fillestare të dhe finale të buxhetit, te kolona të hyrat vetanake, janë shpalosur gabimisht të hyrat e realizuara gjatë vitit në vlerë 1,031,655€.
- Te shpalosja e të hyrave të dedikuara, gabimisht janë prezantuar të hyrat nga fondet e donatorëve të pashpenzuara në vlerë 2,358€.

Pas identifikimit të gabimeve dhe këshillave nga auditimi, përveç çështjeve të keqklasifikimit, Komuna kishte ndërmarrë veprime dhe kishte bërë korrigjimet e nevojshme.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve të brendshme të pamjaftueshme në analizimin dhe prezantimin e të dhënave në raportin financiar.

Ndikimi

Përveç ndikimit që mund të ketë në opinionin e auditimit, mos përgatitja e PVF sipas kërkesave ligjore për raportim, ndikon edhe në prezantimin e pasaktë të fondeve buxhetore për Qeverinë dhe palët e interesit.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë se PVF për vitin 2022 përgatiten sipas standardeve dhe kërkesave ligjore për raportim financiar. Informatat buxhetore të shpalosen në fondet përkatëse buxhetore. Para nënshkrimit të Deklaratës për PVF, Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurojnë se informatat financiare janë prezantuar drejtë dhe saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike jo përkatëse

Gjetja

Me planin kontabël të thesarit janë përcaktuar kategoritë dhe kodet përkatëse ekonomike me të cilat regjistrohen dhe klasifikohen shpenzimet.

Bashkëfinancimi i projektit për përkrahjen e familjeve me ferma të vogla në rritjen, zhvillimin dhe prodhimtarinë e tyre bujqësore e blegtorale (sera) në vlerë 50,000€, është paguar nga buxheti i investimeve kapitale, ndonëse natyra e shpenzimit ka të bëjë me subvencione dhe transfere.

Nga buxheti i investimeve kapitale janë paguar 10,000€ për furnizim me inventar për QKMF-në, që për nga natyra dhe vlera këto furnizime i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Gjithashtu, përmes vendimeve gjyqësore, në emër të pagave jubilarë janë paguar 23,669€ nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve që për nga natyra i takojnë kategorisë për paga e mëditje.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve të pamjaftueshme në planifikimin dhe regjistrimin e shpenzimeve në kategorinë përkatëse ekonomike.

Ndikimi Klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë jo përkatëse ndikon në pasqyrim jo të drejtë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet klasifikohen dhe paguhen nga buxheti i kategorive përkatëse ekonomike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga e Mëditje ishte 4,240,542€ dhe deri në fund të vitit ishte realizuar tërë buxheti. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 644 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 585 punëtor me orar të plotë dhe 69 punëtor me orar të shkurtuar.

Çështja A6 - Parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit

Gjetja	<p>Ligji nr. 06/L-114 për zyrtarët publik, neni 67, përcakton që themelimi i marrëdhënies së punës për një nëpunës të shërbimit publik bëhet vetëm në bazë të një konkursi publik të hapur, të organizuar sipas këtij ligji.</p> <p>Punësimi i tre mësimdhënësve dhe një edukatore ishte bërë pa zhvilluar procedurë të rregulltë të rekrutimit. Tre prej tyre, kishin aplikuar në konkurset e mëhershme por nuk ishin përzgjedhur pasi kishin rezultuar të pasuksesshëm. Ata janë angazhuar në zëvendësimin e punonjësve në pushime të lehonisë, por pas kthimit të punonjësve nga pushimi, kontratat e tyre nuk janë ndërprerë, por janë bërë kontrata të reja të punës.</p> <p>Gjithashtu, dy (2) mësimdhënësve për arsimin e të rriturve, ishin angazhuar pa ndonjë procedurë formale, dhe paguhen nga buxheti për mallra dhe shërbime.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit të dobët të kontrolleve të brendshme dhe mos zbatimit të kërkesave ligjore për procedurat e rekrutimit të personelit. Ndërsa, nga komuna janë arsyetuar se angazhimi i tyre është bërë për shkak të rrethanave të krijuara nga covid-19.</p>
Ndikimi	<p>Mos zbatimi i procedurave të rregullta dhe konkurruese të rekrutimit pamundëson përzgjedhjen e kandidatëve meritore dhe kompetent për pozitën e punës.</p>
Rekomandimi A6	<p>Kryetari duhet të sigurojë se rekrutimi i punonjësve realizohet vetëm në bazë të konkursit publik të hapur dhe konkurrues. Kontratat e punës për kohë të caktuar të ndërpriten me skadimin e afatit apo përmbushjes së kushteve kontraktuale.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2021 ishte 1,498,201€, prej tyre ishin shpenzuar 1,384,946€ apo 92.4%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, mirëmbajtje të ndërtesave, furnizimeve për shkolla, furnizime mjekësore, furnizime higjienike, furnizime zyre, rrymë, etj.

Çështja B2 - Parregullsitë për pozicionet e peshuara në specifikacionin teknik të kontratës

Gjetja Në shpjegimin e KRPP-së, nr. 68, përcaktohet që autoriteti kontraktues (AK) duhet të luajnë një rol aktiv në përcaktimin sa më të saktë të vlerës së parashikuar e më këtë edhe vlerës së kontratës (të realizuar). Duke pasur parasysh faktin se peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që edhe sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë, por të ruajnë të njëjtin raport.

Kontrata publike për *Mirëmbajtjen e parqeve, hapësirave të gjelbëruara dhe shesheve* në vlerë të parashikuar prej 210,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në pesë kategori kryesore, të peshuar sipas rëndësisë me 20% secili prej tyre. Për pozicionin 1, të peshuar me 20% të vlerës së kontratës, janë paguar deri në përfundim të kontratës 178,869€, apo 88% e pagesave të përgjithshme të kontratës, duke e humbur raportin ndërmjet sasisë së realizuar dhe peshës së dhënë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të nevojave nga njësia kërkuese dhe mungesës së kontrolleve adekuate në menaxhimin e kontratave.

Ndikimi Ndryshimi i raportit të peshimit apo përqindjes mes planifikimit dhe pagesave ka ndikuar negativisht te shërbimet e kategorive tjera të kontraktuara të përfunduar. Mos ruajtja e përqindjes apo peshimit të kategorive të kontraktuara shkakton kosto shtesë buxhetore për shkak se raporti i peshimit është faktor kryesor në në përzgjedhjen e tenderit apo ofertës më të lirë gjatë procedurës së prokurimit.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që te kontratave publike të përcaktuara në bazë të përqindjes apo peshimit të pozicioneve të kontraktuara, i njëjti raport i peshimit të ruhet edhe gjatë realizimit përkatësisht pagesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,972,023€, prej tyre në vitin 2021 ishin shpenzuar 4,053,101€ apo 81.5%. Ato kanë të bëjnë me investimet në infrastrukturën rrugore, objekte kulturore, arsimore dhe shëndetësore, mirëmbajtje investive, shpronësime, kanalizim, furnizime me paisje, etj.

Çështja A7 - Parregullsi në pagesa dhe menaxhim të kontratave publike

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), pika 20.8 përcakton që asnjë specifikim nuk do të lëshohet me referencë ndaj një marke të caktuar tregtare, emër të brendit, patentë, dizajn, lloj, origjinë specifike, prodhues, montues, katalog ose artikull me numër. Gjithashtu, me specifikacionin teknik të kontratës publike është përcaktuar sasia e punëve dhe kushtet tjera që kontraktuesi duhet ti realizojë.

Te kontrata Ndërtimi i Sheshit Adem Preniqi në vlerë 989,026€, është konstatuar se punimet nuk janë realizuar sipas kontratës. Në situacionin përfundimtar të punimeve disa pozicione kishin dallime në mes të sasisë së planifikuar dhe të realizuar. Kryesisht kjo është hasur te punët ndërtimore dhe punët e betonit. Sipas paramases dhe parallogarisë, pjesa 9. Punët e elementeve mikrourbane, pozicionet nr. 9.5, 9.6, 9.10, 9.11, 9.12, si dhe pjesa 10 Paisjet sportive në këndin e rekreacionit, në vlerë totale 38,390€ nuk ishin realizuar dhe as paguar.

Gjithashtu, disa pozicione të paguara nuk ishin realizuar sipas situacionit të aprovuar, dhe kjo është hasur në këto pozicione:

- Te instalimet elektrike, pozicioni 12. furnizimi dhe montimi i trupit ndriçues DOMINO 2 x ML ishin llogaritur 97 copë, ndërsa ishin vendosur 85 copë, mbipagesa është 3,480€.
- Te punët e elementeve mikrourbane, mbipagesat totale janë 10,120€, dhe këto janë hasur te: pozicioni 9.1 furnizimi, transporti dhe montimi i ulëses në formë rrethore, ishin llogaritur 13 copë ndërsa janë realizuar 3 copë, pozicioni 9.7 furnizimi, transporti dhe instalimi i mbajtësve për biçikleta nuk është realizuar, ndërsa janë llogaritur 2 copë, pozicioni 9.8 shportat për mbeturina, nuk ishte vendosur formati i shportës sipas detalit në projekt në formë katërkëndëshe dhe me dimensionet e përcaktuara, por lloj i rrumbullakët i shportës, pozicioni 9.9 furnizimi, transporti dhe montimi i rrethojës metalike të parkut përgjatë tërë perimetrit të parkut, ishin realizuar 58 copë, ndërsa janë paguar 110 copë, ndërsa me paramasë ishte paraparë të vendoseshin 390 copë.
- Te punët për fontanën, pozicioni 1.6 Furnizimi dhe montimi spërkatësi i ujit për fontanë me të gjitha elementet përcjellëse fazonike DN32mm 6 copë, në vlerë 2,100€, nuk përshtatej sipas detalit të projektit.

Pas përfundimit të auditimit, për këto mospërputhje nga Komuna kanë ofruar shpjegime se janë bërë disa plotësime dhe ndryshime të pozicioneve për shkak të planifikimeve në realizim të projektit, por pa ndonjë ndryshim financiar. Gjithashtu, janë deklaruar se në mungesë të furnizimeve për shportat a kontraktuara janë pranuar furnizime tjera të ngjashme, ndërsa për vendosjen e mbajtësve për biçikleta në vlerë 1,000€, pas përfundimit të

auditimit janë ofruar dëshmi se është realizuar furnizimi.

Po ashtu, te kontrata për Ndërtimin e bibliotekës së qytetit në vlerë 272,272€, në paramasë dhe paralogari, pjesa 3 pozicioni 1.1 Termopompa Mitsubishi, është përcaktuar lloji apo marka tregtare e paisjes, që me rregullat e prokurimit është e ndaluar. Projekti ishte realizuar brenda çmimit të kontratës, por disa pozicione të paramasës kishin dallime në mes sasisë së planifikuar dhe sasisë së realizuar. Projekti ishte realizuar me 10 muaj vonesë, kjo për shkak të mospajtimit rreth punëve të realizuara mes kontraktuesit dhe komunës / menaxheres së kontratës, dhe formimit të sërishëm të komisionit të pranimit në fund të vitit për vlerësimin e punëve të realizuara.

Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimeve joadekuate dhe kontrolleve të pamjaftueshme në mbikëqyrjen e realizimit projekteve kapitale.

Ndikimi

Aprovimi për pagesë i punëve të perealizuara ndikon në dëmtimin e buxhetit. Përcaktimi i llojit apo markës në specifikimin teknik ka ndikim diskriminues ndaj OE që posedojnë produkte të llojit apo markës tjetër.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin dhe sigurojnë se kontratat publike po realizohen sipas kushteve kontraktuale. Gjithashtu të sigurohet se specifikimet teknike të kontratës nuk përcaktojnë llojin apo markën tregtare të paisjeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PFV e vitit 2021 është 56,797,874€, pasurive jokapitale është 507,412€, si dhe e stoqeve 421,915€.

Çështja A8 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë jofinanciare

Gjetja Me Rregulloren MF-Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, kërkohet që pasuria kapitale të regjistrohet në SIMFK, pasuria jokapitale dhe stoqet të regjistrohen në sistemin e-pasuria, dhe se të gjitha pasuritë i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Gjithashtu kërkohet që në fund të vitit të bëhet inventarizimi i pasurisë.

Në sistemin e-pasuria nuk është llogaritur në tërësi zhvlerësimin e pasurisë jokapitale. Për tre vitet e fundit (2019-2020-2021) nuk është aplikuar zhvlerësimi vjetor i pasurisë. Sipas regjistrimit të pasurisë të prezantuar në aneks të pasqyrës financiare vjetore, kosto fillestare është 529,559€ ndërsa vlera neto 507,412€.

Gjithashtu, është konstatuar se në regjistrin e pasurisë jokapitale janë përfshirë edhe paisje në vlerë 21,362€ që i takojnë pasurisë kapitale. Ndërsa, në dy (2) raste, vlera e faturës për paisjet (spirometer dhe optotip) nuk përshtatej me vlerën e prezantuar në regjistrin e pasurisë, ku dallimet në vlerë janë 32,474€. Komuna nuk ka bërë as inventarizimin e pasurisë për vitin 2021.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë jofinanciare, si dhe me vështirësitë në aplikimin e programit e-pasuria.

Ndikimi Mangësitë aktuale në menaxhim dhe regjistrim të pasurisë jofinanciare, përveç efekteve negative që kanë në raportimin vjetor financiar, pamundësojnë edhe menaxhimin adekuat të saj.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë se kërkesat për regjistrim, zhvlerësim dhe inventarizim të pasurisë zbatohen në pajtim me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 02/2013.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Të arkëtueshmet

Komuna e Obiliqit në PFV e vitit 2021 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LI/A) në vlerë 1,346,235€, ku në raport me vitin 2020 të arkëtueshmet janë rritur për 6%. Kryesisht kjo vlerë përbëhet nga të hyrat e pa arkëtuara nga tatimi në pronë, si dhe pjesa tjetër nga lejet ndërtimore, shfrytëzimi i hapësirave publike, shitja e banesave dhe qiraja, taksat në biznes dhe nga taksat për ndërrimin e destinimit të tokës.

Çështja A9 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenin 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10€) dhe neni 27 nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna nuk ka arritë të menaxhojë si duhet llogaritë e arkëtueshme. Llogaritë e arkëtueshme kanë trend rritës përgjatë tre viteve, ku në fund të vitit 2021 të arkëtueshmet kishin arritur vlerën prej 1,346,235€, duke shënuar rritje për 6% apo 80,493€ në raport me të arkëtueshmet e vitit 2020 që ishin 1,265,742€. Pjesa më e madhe e LI/A ka të bëjë me tatimin në pronë të cilat kanë arritur vlerën 893,369€ po 66% e saldove totale të LI/A.

Mungesa e kontrolleve adekuate në menaxhim dhe inkasim të të hyrave ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme. Komuna nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për inkasimin e të hyrave nga obliguesit e saj.

Ndikimi

Mos inkasimi i LI/A reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Njëkohësisht kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi A9

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.7 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me vetëm një auditor të brendshëm. NjAB ka përgatitur planin vjetor dhe planin strategjik. Komiteti i Auditimit gjatë vitit ka mbajtur 5 takime pune.

Çështja B3 - Nivel i ulët i realizimit të planit vjetor të auditimit të brendshëm, dhe vonesa në raportim në Njësinë Qendrore Harmonizuese (NjQH)

Gjetja Plani vjetor i auditimit pritet të realizohet brenda vitit në përputhje me afatet e përcaktuara. Rregullorja QRK-Nr. 01/2019, neni 11, pika 4, përcakton që drejtori i NjAB-së përgatitë dhe dorëzon raportin e gjashtëmuorit të parë dhe të dytë, si dhe raportin vjetor tek udhëheqësi i organizatës, komiteti i auditimit dhe NjQH më së largu deri me 15 korrik të vitit, gjegjësisht deri më 15 janar të vitit vijues.

Gjatë vitit 2021 Auditori i Brendshëm (AB) ka realizuar vetëm dy raporte të auditimit nga pesë të planifikuara. Aktivitetet e përfshira nën auditim i takojnë gjysmës së dytë të vitit 2020 dhe tremujorin e parë të vitit aktual. AB nuk ka raportuar në NJQH raportin gjashtëmuor dhe raportin vjetor brenda afatit kohor ligjor. Raportet ishin dorëzuar me rreth tre muaj vonesë.

Kjo ka ndodhur për shkak të angazhimit të pamjaftueshëm të auditimit të brendshëm dhe mungesës së monitorimit të aktiviteteve të auditimit.

Ndikimi Në mungesë të auditimeve të brendshme menaxhmentit nuk i është ofruar informacion për funksionalitetin dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme në organizatë.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se NjAB realizon planin vjetor të auditimit brenda afateve të përcaktuara, dhe se kërkesat ligjore për raportim nga NjAB realizohen brenda afateve të përcaktuara me rregulloren përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	11,190,796	11,669,873	10,610,302	10,711,191	10,736,832
Grante Qeveritare - Buxheti	10,240,616	10,211,460	9,300,101	9,330,099	9,849,470
Financimi përmes huamarrjes	0	22,565	20,389	59,535	5,190
Të bartura nga viti i kaluar	0	483,151	412,225	631,929	398,312
Të hyrat vetanake	950,180	950,180	877,427	680,088	478,178
Donacionet vendore	0	2,360	160	0	5,682
Donacionet e jashtme	0	158	0	9,540	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 479,078€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 483,151€, financimet nga huamarrja në vlerë 22,565€, donacioneve në vlerë 2,518€, vendimit të qeverisë për kompensimin e dëmeve nga vërshimet 23,500€, dhe shkurtimeve buxhetore të fund të vitit në vlerë 52,656€.

Në vitin 2021 OB ka shpenzuar 91% të buxhetit final, me një përmirësim prej 6% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	11,190,796	11,669,873	10,610,302	10,711,191	10,736,832
Pagat dhe mëditjet	4,273,658	4,240,542	4,240,542	4,229,433	3,908,949
Mallrat dhe shërbimet	993,930	1,162,519	1,129,767	891,321	717,364
Komunalitë	316,675	335,681	255,179	209,633	246,323
Subvencionet dhe transferet	830,000	959,107	931,713	1,005,138	632,161
Investimet Kapitale	4,776,533	4,972,023	4,053,101	4,375,666	5,232,035

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga e mëditje është zvogëluar për 33,115€. Fillimisht buxheti është rritur për 19,541€ nga fondi financimet për huamarrje, mjete këto të shpenzuara për shërbimet e kujdesit parësor, dhe në fund të vitit për shkak të tepricave buxhetore, me vendim të qeverisë janë bërë shkurtime buxhetore në vlerë 52,656€.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime është rritur për 168,589€. Kjo rritje është ndikuar nga të hyrat e bartura në vlerë 138,548€, nga fondi financimet për huamarrje 3,024€, pranimet nga donacionet 1,658€, nga transferi i brendshëm prej buxhetit të shpenzimeve komunale shuma prej 19,006€ dhe me vendim të Qeverisë për 6,353€.
- Buxheti për shërbimet komunale është zvogëluar për 19,006€, dhe kjo shumë është alokuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur për 129,107€. Kjo rritje e buxhetit është rrjedhë nga të hyrat e bartura të vitit paraprak në vlerë 105,607€, dhe nga vendimi i qeverisë për kompensimet e dëmeve nga vërshimet në shumën 23,500€.
- Buxheti final për investime kapitale është rritur për 195,489€, nga të hyrat e bartura prej 194,630€ dhe 860€ nga donacionet. Përkundër një rritje të buxhetit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit, vetëm 82% e buxhetit ishte shpenzuar. Programi i Investimeve Publike përfshin të përfshira në ligjin e buxhetit vetëm projektet në vazhdim nga viti i kaluar. Për projektin e Laboratori Mobil në vlerë 350,000€ nuk është realizuar asnjë pagesë gjatë vitit 2021, ndërsa buxheti për projektin Koogjenerimi në vlerë 616,928€ ishte realizuar vetëm 65%, kjo si rezultat i intervenimeve për zhvendosjen e gypit të ujitjes të N.H. Ibër Lepenc. Edhe projekte tjera kapitale nuk ishin realizuar në nivelin e pritur. Vonesat në zbatim janë gjithashtu të dukshme në disa projekte të filluara para vitit 2021.

Komuna e Obiliqit ka përfituar nga programi i rimëkëmbjes ekonomike mjete në vlerë 159,919€, të cilat janë shfrytëzuar për financimin e pagave dhe mëditjeve për shërbimet e shëndetësisë primare, shërbimet sociale, dhe në sektorin e arsimit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e planifikuara për vitin 2021 ishin 950,180€, ndërsa janë realizuar 1,031,656€, duke tejkaluar planin për 81,475€ apo 8.6%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu, në vitin 2021 Komuna e Obiliqit ka përfituar të hyra nga gjobat në trafik në vlerë 143,776€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikon dhe i realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	950,180	950,180	1,031,656	776,820	972,594
Të hyrat tatimore	400,477	400,477	373,705	362,267	485,616
Të hyrat jo tatimore	549,703	549,703	657,950	414,553	486,978

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 për Komunën e Obiliqit ka rezultuar me 11 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2020 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në kuvendin komunal të Obiliqit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, tetë (8) rekomandime janë zbatuar dhe tre (3) të tjera nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të monitoroj realizimin efektiv të të hyrave duke analizuar shkaqet e rritjes së llogarive të pa arkëtuara dhe me raste, të sigurojë që të iniciohen procedura nëpërmes gjykatës apo përmbauesve për ti mbledhur borxhet nga bizneset.	Janë ndërmarrë veprime, të arkëtueshmet nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë janë zvogëluar për rreth 6%.	I zbatuar
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave mbi pronën për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar

3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit pas nënshkrimit të kontratës përgatitë dhe dërgon me kohë urdhrin për blerje, e cila së bashku me zotimin e mjeteve financiare në SIMFK i paraprijnë furnizimit të mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu duhet të sigurojë se aplikohen ndëshkimet në rastet kur vonesat në realizim të kontratës nuk arsyetohen.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që plani i prokurimit do të përfshijë të gjitha kërkesat nga njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit, dhe në raste specifike kur aktiviteti nuk është përfshirë në plan, parapraktisht të njoftohet AQP. Po ashtu, kryetari të sigurojë që kërkesat nga njësitë kërkuese të planifikohen në bazë të nevojave reale si dhe furnizimet përmes kontratave publike kornizë të mos tejkalojnë limitet e lejuara të devijimit prej +/-30%.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i përzgjedhjes së projekteve për financim të zhvillohet duke aplikuar të gjitha kërkesat dhe formatet/formularët standard të përcaktuara me Rregulloren MF-Nr. 04 2017 për subvencionim të OJQ-ve. Përkrahjes financiare ti paraprijë thirrja publike përmes së cilës përcaktohen qartë kriteret dhe kushtet tjera për pjesëmarrje që duhet të përmbushen nga përfituesit e mundshëm. Po ashtu, regjistrimi i shpenzimeve duhet të bëhet në kodet përkatëse të parapara në planin kontabël.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesave ligjore në përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-te, dhe raportimin e planit në ZKM në afatin e përcaktuar.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se funksionojnë kontrollet në realizimin e kontratave në pajtim me kushtet kontraktuale. Menaxherët e kontratave të përgatitin planin për menaxhimin e kontratave dhe ta azhurnojnë me informatat plotësuese rreth realizimit dhe përmbylljes së kontratës si dhe të mbajnë shënime në ditarin e punës dhe librin ndërtimor për punët e realizuara. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë se bëhet ndarje e drejtë e detyrave dhe përgjegjësisë për zyrtarët të cilët janë pjesë e proceseve për të shmangur çfarëdo konflikti të mundshëm të interesit.	Janë ndërmarrë disa veprime.	I zbatuar

8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se pagesat e paradhënies të bëhen në pajtim me Ligjin e Buxhetit, në mënyrë që mos të ketë pagesa përtej limiteve të lejuara sipas kërkesave ligjore.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj kontrollë dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
10.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se në rastet kur aplikohen procedurat e prokurimit për kontratat me çmime për njësi, pesha të përcaktohet në bazë të rëndësisë që ka secila kategori e shërbimeve ose secili artikull, në mënyrë që të përcaktohet oferta më e lirë. Gjithashtu, të sigurojë ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes nga menaxherët e kontratave, dhe rritjen e cilësisë së planifikimeve të nevojave nga njësitë kërkuese. Mekanizmat e kontrollit të përforcohen edhe në çertifikim të pagesave, me qëllim evitimin e pagesave të parregullta.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të siguroj se NJAB do të angazhohet që të përmbushë planin e auditimit në mënyrë që ti ofroj menaxhmentit një pasqyrë të qartë rreth funksionimit të organizatës ku pastaj të ketë mundësi që ti marrë masat për ti korrigjuar gabimet.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Illir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Obiliqit, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Xhafer Gashi
Kryetar i Komunës,
Data: 25.Maj.2022.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.